



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencija za Razvoj Poloprivrede/ Agriculture Development Agency

ZYRA PER KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/ KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/
/OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION/

THIRRJE PËR APLIKIM PËR FERMERËT DHE EKONOMITË BUJQËSORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR PËRFITIM NE KUADËR TE IMPLEMENTIMIT TE “PLANIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2014-20”, **MASA 101** ,, INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË EKONOMITË BUJQËSORE,, SEKTORI I PEMËVE ,PERIMEVE (PËRFSHIRE PATATET) SEKTORI I RRUSHIT DHE SEKTORI I DRITHËRAVE

Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare/granteve për investime në ferma në kuadër të Masës 101», INVESTIMET NE ASETET FIZIKE NE EKONOMITË BUJQËSORE,, « sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, Për sektorin e pemëve ,perimeve (perfs hire edhe patatet) sektorin e rrushit ,dhe sektorin e drithërave.

Përfituesit e pranueshëm

Përfituesit e pranueshëm për këtë masë janë personat fizikë dhe juridik. Ata duhet të jenë banor të përhershëm të Republikës së Kosovës (personat fizikë) ose të jenë të regjistruar në regjistrin e biznesit në Kosovë (personat juridik), ata duhet t'i përmbushin kushtet sipas kësaj thirrje për aplikim.

1. Shtirirja gjeografike

Tërë territori i Republikës së Kosovës

2. Sektori i Pemëve (molla, dardha, kumbulla, vishnja, dredhëza, mjedra dhe manaferra)

Ne momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, aplikantët duhet të dëshmojnë ekzistimin e sipërfaqeve në pronësi apo të marra me qira në Regjistrin e Fermave prej së paku 0.5 ha për pemë farore dhe/ose 0.25 ha për pemë manore (pemë të imta: dredhëza, mjedra dhe manaferra);

- Në rast të investimeve në makineri bujqësore dhe pajisje dhe/ose investime në ndërtim dhe përmirësim të objekteve, investimi duhet të përputhet me kapacitetet prodhuese;

2.1 Investimet në sektorin e pemëve(molla, dardha, kumbulla, vishnja, dredhëza, mjedra dhe manaferra)

- Investimet në ngritjen e pemishteve të reja me madhësi minimale prej 0.5 ha për pemë farore dhe 0,25 ha për pemë manore.
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes në fermë sipas praktikave efikase të ujitjes.
- Investimet në pajisje eficiente për energji ose prodhimi i energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme.
- Investimet në vendosjen e rrjetave për mbrojtje nga breshëri.
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas-vjeljes.
- Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pas-vjeljes, objekteve për vendosjen e makinave dhe objekteve për vendosjen e produkteve për mbrojtje të bimëve dhe plehra artificiale.

3.Sektori i perimeve, përfshirë patatet

-
- Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e perimtarisë/patateve, aplikantët duhet të dëshmojnë ekzistimin e sipërfaqeve të tokës së punueshme, në pronësi apo të marra me qira të regjistruar në Regjistrin e Fermave prej së paku 2 ha nëse aplikojnë për perime në fushë të hapur ose 4 ha nëse aplikojnë për patate;
 - Në rast të investimeve në ndërtimin e serrave të reja permanente, ekonomia bujqësore (ferma) duhet të dëshmojë se ka së paku 0.10 ha tokë të punueshme të regjistruar në Regjistrin e Fermave.

3.1 Investimet në sektorin e perimeve (përfshirë patatet)

-
- Investimet në ndërtimin/riparimin dhe modernizimin e serrave të përhershme për perimtari apo fidanishte me madhësi minimale prej 0.10 ha. Investimet në pajisje efikase për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme,
 - Blerja dhe instalimi i paisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike dhe atyre për kultivim pa dhe (soil-less),
 - Investimet në vendosjen ose avancimin e sistemeve të ujitjes në fermë sipas praktikave efikase të ujitjes,
 - Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për mbrojtje të bimëve; plehërim, vjelje dhe pas-vjelje,
 - Ndërtimin e objekteve për ruajtje të prodhimit, objekteve për mbajtje të makinerisë bujqësore, dhe depove për produktet për mbrojtje të bimëve dhe plehrat artificiale.

4. Sektori i drithërave

Aplikuesit për investime ne sektorin e drithërave, duhet të dëshmojnë posedimin e tokës së punueshme në pronësi apo të marrë me qira, të regjistruar në Regjistrin e Fermës dhe atë së paku 6 ha për misër dhe 15 ha për drithëra tjerë.

4.1 Investimet në sektorin e drithërave

- Investime në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të drithërave, makineri për mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrje.
- Ndërtimi dhe përmirësimi i pronës së paluajtshme si ndërtimi i siloseve, objekte për mbajtjen e makinerisë bujqësore, pajisjeve dhe depove për produktet për mbrojtje të bimëve dhe plehtrat artificiale.
- Investimet në pajisje efçiente për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme.

5. Sektori i rrushit

- Ne momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e rrushit duhet të dëshmojnë posedimin e tokës bujqësore në pronësi apo të marrë me qira, të regjistruar në Regjistrin e Fermës dhe në Regjistrin e Vreshtave, për së paku 10 vjet dhe atë 0.5 ha për rrush të tryezës ose 1 ha për rrush të verës.

Në rast të investimeve në mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, aplikuesit duhet të dëshmojnë se posedojnë së paku 4 hektar me vreshta, në pronësi apo të marrë me qira, të regjistruar në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës.

5.1 Investimet në sektorin e rrushit

- Investimet në ngritjen/modernizimin e plantacioneve të vreshtave (konvertim, , zëvendësim) për rrush tryeze dhe rrush vere me madhësi minimale 0.5 ha për rrush të tryezës dhe 1 ha për rrush të verës,
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes sipas praktikave efçiente të ujitjes,
- Investimet në pajisje efçiente për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme,
- Investimet në vendosjen e rrjetave për mbrojtje nga breshëri,
- Investimet në sisteme mbajtëse të hardhive dhe rrethoja,
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për vreshta, makineri për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas-vjeljes,
- Ndërtimi i depove për produktet për mbrojtje të bimëve dhe plehtrat artificiale.

Atyre që kanë mbi 4 ha vreshta u lejohet edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim, etj. Objekte për mbajtje të makinerisë bujqësore dhe pajisjeve si dhe ndërtimi i depove për produktet për mbrojtje të bimëve dhe plehtrat artificiale.

6. Dokumentet e bashkangjitura

- 1. Formulari për aplikim** - sipas modelit të AZHB-se e rekomanduar të plotësohet me kompjuter ose makin.
- 2 Kopje e letërnjoftimit**- është letërnjoftimi i lëshuar nga Republika e Kosovës dhe a është i vlefshëm në momentin e aplikimit.
- 3 Certifikata e lindjes**,- kopje
- 4. Formulari për indikator** - i plotësuar (në original)
- 5 Llogaria rrjedhëse**, -dokument i lëshuar dhe vulosur nga banka (në origjinal)
Llogaria rrjedhëse duhet të jetë nga një bankë që operon në Kosovë
- 6. Regjistrimi në regjistrin e fermës**
- 7. Certifikata e numrit fiskal** – kopje Në rastin e personave juridik:
- 8. Plani i biznesit** - në rastin e projekteve në vlerë mbi 20.000 € ose **Projekt propozimi** – në rast të projekteve me vlerë deri në 20.000 €. Zyrtari verifikon nëse këto dy dokumente janë në përputhje me modelin e AZHB-së.
- 9. Certifikata e regjistrimit në regjistrin e fermës**-për të dëshmuar përvojën mbi trevjeçare në bujqësi – kopje ose **Vërtetim nga punëdhënësi**- se aplikanti ka më shumë se tri vjet përvojë pune në bujqësi ose **Diploma e fakultetit** të Bujqësisë, Veterinarisë apo Teknologjisë së Ushqimit – kopje ose **Diploma e shkollës së mesme bujqësore** – kopje ose **Certifikate e ndjekjes së trajnimeve** përkatëse nga një institucion edukativ apo shërbim këshillëdhënës në të cilën dëshmohet se aplikanti ka ndjekur se paku 150 orë mësimi dhe temat e trajtuara – kopje.
- 10. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës** që dëshmon se aplikanti nuk ka obligime të papaguara (në origjinal) Për personat juridik
Vërtetim nga komuna që ka paguar tatimin në pronë Për personat fizik:
- 11 Autorizimi**- Në rast se aplikimi bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri.
- 12. Kontrata e punës** së përfaqësuesit të ndërmarrjes për së paku për 5 vjet. Në rastin e personave juridik
- 13. Dokumenti që dëshmon pronësinë mbi tokën** ose **kontrata e qiramarrjes së tokës** për së paku 5 vjet (nga noteri) Në rast të projekteve që parashohin ndërtim ose ngritje të pemishtes apo vreshtit
- 14. Lista e kontratave**- me përpunuesit ose blerësit dhe kopjet e kontratave – nëse aplikuesi i posedon ato (nuk janë të obligueshme, por janë kriter i përzgjedhjes)
- 15. Deklarata se investimi pasi të përfundohet, përmbushë standardet e minimale kombëtare** (nuk është e obligueshme, por është kriter i përzgjedhjes)
- 16. Diploma e përgatitjes shkollore për bujqësi** dhe më shumë se tri vjet përvojë përkatëse (nuk është e obligueshme, por është kriter i përzgjedhjes)

Dokumente tjera specifike

- 1- Rrushi**- Certifikata nga regjistri Kadastral i Vreshtave

Te gjithë përfituesit e projekteve duhet të respektojnë rregullat dhe procedurat e prokurimit publik që janë të bashkangjitura si shtojcë e kontratës që fermeri e nënshkruan me Agjencionin e Zhvillimit të Bujqësisë;

7.Shkalla e përkrahjes publike

Intensiteti total i përkrahjes publike (nga buxheti kombëtar dhe fondet e BE-së) mund të jete deri ne 60% të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Përkrahje shtesë jepet për:

- 5% për investimet në ekonomi bujqësore (ferma) nga fermerët e ri,
- 10% për investimet në ekonomitë bujqësore (ferma) në viset malore (lista në udhëzuesin për aplikant),
- 10% për investimet në gropë septike për mbrojtje të mjedisit.

8.Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve

Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim.

Thirrja për aplikim do të jete e hapur 45 ditë kalendarike për sektorin e pemëve,perimeve (përfshirë edhe patatet) sektorin e rrushit ,dhe sektorin e drithërave.

PS -Për sektorin pemë ngritje dhe rrush ngritje per afatin e mbjelljes Pranverë -Vjeshtë aplikuesit të deklarohen me rastin e aplikimit

Nga data e publikimit, procedimi i aplikacioneve do të bëhet sipas parimit të kritereve te përzgjedhjes të përcaktuara paraprakisht nga ana e Ministrisë se Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në zyrën Regjionale të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë në: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan nga ora 8:30-16:00 çdo ditë pune.

Per informata me të hollesishme vizitoni web faqen www.mbpzhr-ks.net ,web faqën www.azhb.rks-gov.net si dhe udhëzuesin për aplikant.

9.Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

MBPZHR /AZHB MBPZHR /AZHB

Adresa: Rr: Nazim Gafurri nr.23 (afër gjimnazit "Sami Frashëri")

Nga e Hëna deri të Premten: nga 10.00^h-12.00^h;

e-maili

1	Nehat Veliu		038 211 967	nehat.veliu @rks-gov.net
2	Habibe Dauti			habibe.Dauti@rks-gov.net
3	Berat Nika			berat.nika@rks-gov.net
4	Veton Prekazi			veton.prekazi@rks-gov.net

Çdo ditë pune nga ora 08:30-16:00

Nr.	Regjioni	Adresat	Telefoni	e-maili
1	Prishtina	Zona industriale-Fushë Kosovë, Përballë Maxi-Marketit,	038 601 169	
2	Mitrovica	Mbretresha Teutë pa nr.	028 522 501	
3	Peja	Instituti bujqësor fidanishtja Peje	039 431-276	
4	Gjakova	Marin Brleti nr.2,kati III.	0390 320-992	
5	Prizreni	Avni Rustemi 159	029 244-793	
6	Ferizaji	Dëshmoret e kombit pa nr.	0290 324 661	
7	Gjilani	Rr: Bulevardi i Pavaresisë (Rr. e Ferizaj- it) (Soliteri kati I)	0280 326 106	